

(familjes së tij) me 4950m2 tokë, si dhe kopje të çertifikatës familjare të ankuesit për gjendjen familjere të tij më datë 01.08.1991.

- Vënien në dispozicion të Avokatit të Popullit të kopjes së Urdhërit nr.1787 prot, datë 23.06.2014, “Për refuzimin e regjistrimit të AMTP Nr.33, datë 13.06.1992”.

Për informacionin e kërkuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, sipas shkresave të mësipërme, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, me shkresat nr. 7870/1 Prot, datë 29.12.2016, drejtuar ZVRPP, Tiranë, nr. 7870/1 Prot, datë 29.12.2016, dhe nr.3398/3 Prot, datë 28.07.2017, drejtuar ZQRPP, Tiranë, dhe ZVRPP, Tiranë, ka tërhequr vëmendjen për përmbushjen e detyrimit ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit. Të njëjtin qëndrim ka shprehur dhe ZQRPP, Tiranë, në shkresën nr.4558/2 Prot, datë 09.08.2017, drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Përpos kësaj situate, ZVRPP, Tiranë, pas 10 muajve nga data e kërimit të informacionit në mënyrë të përsëritur, kthen përgjigje Ministrisë së Drejtësisë, dhe jo Institucionit të Avokatit të Popullit, shkresa nr.20213/1 Prot, datë 10.09.2017, lidhur me çështjen e ankuesit E.H..

Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresën nr.K3/E41-2 Prot, datë 22.11.2016, ka kërkuar shpjegime dhe informacion për çështjen, sikurse përcaktuar në këtë shkresë, ndërsa informacioni i dhënë prej saj Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr.20213/1 Prot, datë 10.09.2017, është i paplotë, i paqartë, dhe në “lajthitje” me objektin e kërimit prej Institucionit të Avokatit të Popullit.

Përkundër kësaj situate, si më sipër prezantuar, qëndrimi i punonjësve të ZVRPP, Tiranë, është tregues i shkeljes së parimit të ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efijencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të Ligjit Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të detyrueshme për zbatim në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 1 të këtij Kodi.

Kjo situatë e krijuar prej punonjësve të ZVRPP, Tiranë, gjithashtu nuk vjen në përputhje me parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në Nenin 42/2 të Kushtetutës apo nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Pë ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Ndodhur në situatën si më sipër prezantuar, konstatohet se, Regjistruesi i ZVRPP, Tiranë, nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit, duke u bërë në këtë mënyrë penges për Institucionin e Avokatit të Popullit, në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efijente dhe në një afat sa më të arsyeshëm

Për arsyet e bëra të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se; “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga

Administrata Publike”, si dhe nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

REKOMANDOJMË

Marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj punonjësit të Z.V.R.P.P. Tiranë, i cili nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin ligjor në marrëdhënie me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit, konform parashikimit të kryer në nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë,

Kopje të shkresave;

K3/E41-2 Prot, datë 22.11.2016,

K3/E41-6 Prot, datë 27.12.2017,

K3/E41-7 Prot, datë 18.05.2017,

K3/E41-9 Prot, datë 20.06.2017,

K3/E41-9 Prot, datë 20.06.2017,

të Avokatit të Popullit, drejtuar Regjistruerit të ZVRPP, Tiranë, Kryeregjistruerit të ZQRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr. 7870/1 Prot, datë 29.12.2016, të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, drejtuar ZVRPP, Tiranë,

Kopje të shkresave nr. 7870/1 Prot, datë 29.12.2016, nr.3398/3 Prot, datë 28.07.2017, të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, drejtuar ZQRPP, Tiranë, dhe ZVRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr.2728/2 Prot, datë 17.04.2015, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr.4558/2 Prot, datë 09.08.2017, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Tiranë.

Kopje të shkresës nr.20213/1 Prot, datë 10.09.2017, të ZVRPP, Tiranë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

Kopje të AMTP nr.33, datë 13.06.1992, të nxjerr prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Selitë e Malit, Ish-Komuna Zall-Bastar, Tiranë.

Kopje të kërkesës (aplikimit nr.89179, Datë 20.11.2015) të kryer prej ankuesit E.H.

Kopje të Vërtetimit “Nga dokument hipotekor”, datë 25.11.2013, lëshuar pranarit të pasurisë nr.199, datë 25.11.2013, E.H.

Kopje të Vërtetimit “Nga dokument hipotekor”, datë 25.11.2013, lëshuar pranarit të pasurisë nr.198, datë 25.11.2013, E.H..

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI

Konceptoi dhe Daktilografoi

A.Gjoleka